

Thirrje për Regjizor

Shkodër, 26/03/2019

Pozicioni:	Regjizor për Dance Teatër
Titulli i projektit:	Arti kundër dhunës
Afati përfundimtar i aplikimit:	dt 30/03/2019
Periudha e angazhimit:	Dhjetor 2018 – Maj 2019

1. Përshkrim i përgjithshëm i projektit

Projekti “Arti kundër dhunës” zbatohet në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Bashkia Shkodër, si një ndër 12 bashkitë partnere të Programit ReLOaD në Shqipëri, është bashkëfinancuese dhe bashkëzbatuese e programit, për projektet që po zbatohen në territorin e Bashkisë. Projekti “Arti kundër dhunës” përfshin aktivitete të ndryshme, të cilat materializohen në organizimin e mësimeve jo-formale argëtuese me të vegjël të qytetit (arte figurative dhe muzikë), si edhe me organizimin e një sërë aktiviteteve artistiko-sportive (koncerte, ekspozita, teatër, etj.) me të rinjtë dhe shtresat vulnerabel.

2. Qëllim i kontratës

Qëllimi i kontratës është përgatitja dhe vënia në skenë e 3 shfaqjeve teatrale të cilat trajtojnë problematikën që hasen nga femrat që janë viktime të dhunës. Në shfaqje do të interpretojnë balerinë profesioniste bazuar në krijimtarinë e një koreografi profesionist. Shfaqjet e Dance Teatrit do të vihen në skenë në qytetin e Shkodrës.

3. Detyrimet e regjizorit

Aktiviteti i regjizorit nis menjëherë pas nënshkimit të kontratës.

Ai është përgjegjës për organizimin e punës me grupin që do të përgatisë shfaqjen duke nisur me skenaristin, koreografin, dhe balerinët që do të interpretojnë. Regjizori është përgjegjës për përzgjedhjen e ambientit ku do të vihet në skenë shfaqja dhe për cilësinë artistike të saj, sikurse dhe për qartësinë e mesazhit të transmetuar. Lidhur me çdo problematikë të mundshme, regjizori duhet të raportojë tek Fondacioni “ARTE”.

6. Kohëzgjatja e kontratës

Kontrata nis menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe mbaron në 30 Maj 2019.


7. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati

i. të detyrueshme

- a. Kandidati duhet të zotërojë diplomë Bachelor në një ndër fushat e Arteve Skenike;
- b. Të ketë eksperiencë pune minimalisht 2 vjeçare në cilësinë e regjizorit/asistent regjizorit/aktorit ;
- c. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë;
- d. Të jetë i aftë për punë.

ii. te preferueshme

- a. Të jetë banor në Shkodër;



8. Dokumentacioni

- Letër motivuese ku te shprehet oferta financiare;
- Jetëshkrimi (CV), ku të përfshihen eksperiencia e punës;
- Kopje e ID;
- Fotokopje e Diplomës;
- Vetëdeklarimi për gjendjen shëndetësore “i aftë për punë”;
- Vetëdeklarim gjendjen gjyqësore “i padënuar me vendim të formës së prerë”.

Kandidatët që shpallen fitues duhet të dorëzojnë brenda afatit të përcaktuar nga kontraktuesi dokumentacioni si më poshtë:

- Vërtetim banimi;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Dëshmi e gjendjes shëndetësore

9. Pagesa

Pagesa për Regjizorin do të realizohet sipas kontratës që do të lidhet me Fondacionin Arte.

10. Aplikimi

Aplikimi duhet të dorëzohet **brenda dt. 30/03/2019**, me email në:

fondacioniarte@gmail.com

ose

me postë, në adresën zyrtare të Fondacionit ARTE
Rruga e Kavajës, Pallati 223, Shkalla 3, Kati 4, Apartamenti 23, Tiranë

Përgjigja e rezultateve jepet me email pas tri - pesë ditëve, që nga përfundimi i aplikimit. Kandidati duhet të paraqitet pranë Fondacionit ARTE për nënshkrimin e kontratës brenda 5 ditëve nga data e njoftimit.